

**VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKES**

Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda e perbere prej

GJYQATAR GURALI BRAHIMLLARI

asistuar nga sekretare gjyqesore **SUELA ARAPI(MURATAJ)**, ne prezence te prokurorit Besnik Muçi, ne Tirane , sot me date 14.07.2010, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore jo publike, kerkesen nr 12 date 12.07.2010 qe i perket:

KERKUES: Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda - Tirane, perfaqesuar nga prokurori Besnik Muçi.

OBJEKTI: Sekuestrimi i pasurive

KUNDER: **Shtetasit A.H**, lindur në XXX, Berat dhe banues në Lagj. Nr. xx, XXX Durrës.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër pasurisë”,

Ne perfundim te gjykimit, Gjykata, pasi degjoi pretendimet e prokurorit Besnik Muçi qe kerkoi pranimin e kerkeses si dhe si shqyrtoi aktet e ceshtjen ne teresi

V E R E N s e

Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, ne vitin 2007, ka regjistruar procedimin penal nr. 21, në ngarkim të shtetasve A.H, H.H, F.H, M.SH dhe S.GJ për veprat penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike », « Organizimit dhe drejtimit të organizatave kriminale », parashikuar nga nenet 283/a/1 dhe 284/a të Kodit Penal.

Gjate fazes se hetimeve paraprake, ndaj shtetasve te mesiperem, Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda ka dhene masen e sigurimit « Arrest nw burg », pasi ka vleresuar se ka dyshime te arsyeshme te mbeshtetura ne prova se i dyshuari A.H eshte perfshire ne veprimtarine kriminale per te cilen eshte akuzuar nga Prokuroria.

Mbeshtetur ne provat shkresore te paraqitura nga akuza, del se nga ana e shtetasit A.H në bashkëpunim më persona të tjerë, gjatë vitit 2003, kanë trafikuar nga Shqipëria në Itali sasi të mëdha lëndë narkotike të tipit Heroinë, sasi e cila është kapur dhe sekuestruar nga autoritetet Italiane.

Nga provat e paraqitura rezulton se ka indicje se personi ndaj te cilit kerkohet te sekuestrohet pasuria A.H, ka qene pjese e nje rrjeti trafikantesh te lendeve narkotike qe kane filluar veprimtarine kriminale, **te pakten, qe ne ditet e para te muajit Janar 2003, periudhe ne te cilen kane qene ne pergjim nga autoritet gjyqesore te shtetit Italian.**

Ne perberje te ketij rrjeti kane qene shume shtetas shqiptare e Italian, nje pjese e te cileve jane arrestuar ne flagrance, ne disa episode kriminale, ndersa disa te tjera jane arrestuar e gjykuar me vone nga autoritet Italiane te drejtesise.

Rezulton se si rrjedhoje e ketyre pergjimeve dhe te veprimeve te tjera hetimore te kryera nga autoritet gjyqesore te shtetit Italian, **ne daten 21.01.2003** eshte arrestuar shtetasi shqiptar B.N me 38 kg lende narkotike e llojit heroine, por qe pjese e trafikimit te kesaj lende narkotike kane qene edhe bashketepandehurit e ketij rrejtji kriminal.

Kerkesa per kete gjykim eshte paraqitur nga organi i akuzes pasi çeshtja penale ne ngarkim te te pandehurit A dhe personave te dyshuar si bashkepunetore te tij eshte gjykuar ne shkalle te pare dhe eshte per gjykim ne gjykatën e Apelit.

Pra provohet se pas perfundimit te hetimeve paraprake, i dyshuari A.H se bashku me te pandehurit H.H, F.H, M.SH dhe S.GJ është dërguar për gjykim me akuzen se kane kryer veprat penale te « Organizimit dhe drejtimit të organizatave kriminale », dhe “Trafikimit të lëndëve narkotike », parashikuar nga nenet 283/a/1 dhe 284/a të Kodit Penal.

Gjykata e Shkalles se Pare për Krime të Rënda, pasi ka pranuar kerkesen e te pandehurve per gjykimin e çeshtjes me proceduren e gjykimit te shkurtuar, me Vendimin nr. 10 datë 26.03.2010, ka vendosur midis të tjerave dhe **deklarimin fajtor të të pandehurit A.H për veprën penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike » të kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal** duke e denuar ate perfundimisht me 10 vjet e 8 muaj burgim.

Nga pjesa arsyetuese e **Vendimit nr. 10 datë 26.03.2010 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda**, rezulton se i gjykuari A.H eshte gjendur fajtor per 11 episode kriminale te trafikimit te lendeve narkotike e konkretisht ne datat 17.02.2003 ; 16.03.2003 ; 03.04.2003 ; 14.05.2003 ; 01 dhe 06 Korrik 2003 ; 06 dhe 22 Gusht 2003 ; 17.09.2003 dhe 01.11.2003.

Ndonese ky vendim nuk eshte i formes se prere perfundimet e tij mbajhen ne konsiderate nga gjykata lidhur me kerkesen per sekuestrimin e pasurise sipas nenit 3 te ligjit 10 192 date 03.12.2009.

Pra rezulton se nga ana e akuzes eshte rregjistruar procedimi penal per te pandehurt A.H, se ka perfunduar hetimi paraprak, se ne daten 28.07.2009 ceshtja penale eshte derguar per gjykim, se gjykimi penal ka perfunduar ne shkalle te pare dhe se sipas vendimit gjyqesor te sipercituar, rezulton se i pandehuri A.H eshte gjendur fajtor per kryerjen e vepres penale te **“Trafikimit të lëndëve narkotike » të kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal ».**

Mbi kete baze, rezulton se akuza ka rregjistruar edhe procedimin pasuror ne daten 25.06.2010, dhe pasi eshte kryer hetimi pasuror kjo ceshtje eshte tashme ne gjykim, me objektin e sekuestrimit te pasurise qe eshte verifikuar nga akuza se eshte ne pronesi apo ne perdorim te te pandehurt A.H dhe familjareve te tij.

Ne keto kushte, gjykata gvlereson se kerkesa e prokurorise eshte e mbeshtetur ne prova e ne ligj dhe se duhet te pranohet.

Provohet se vepra penale per te cilen dyshgohet se eshte perfshire, madje edhe se eshte gjetur fajtor me vendim gjyqesor, shtetasi A.H , hyn në kategorinë e veprave penale të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 « Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive ».

Ndonese procedimi penal per kete te pandehur dhe per bashkepunetoret e tij ka filluar, nga autoritetet gjyqesore te vendit tone, ne vitin 2007, ndersa perfshirja ne veprimtarine e mesiperme kriminale e personit qe kerkohet t'i sekuestrohet pasuria, i perkete periudhes, te pakten Janar- Nentor 2003, ne baze te nenit 3 / 4 te ligjit 10 192 date 03.12.2009, gjykata e gjen te drejte pretendimin e prokurorise se veprimin e ketij ligji ndaj pasurise se shtetasit A.H. Ndersa sipas parashikimit te nenit 3/2 te ketij ligji, masat e sekuestrimit a konfiskimit pasuror mund te vendosen edhe ndaj pasurise se personave te afert te tij.

Nga hetimi pasuror i kryer nga policia gjqyesore nen drejtimin e Prokurorit, sipas parashikimit te neneit 6 te ligjit 10 192, akuza pretendon se si rrjedhoje e veprimtarise kriminale ne fushen e narkotikeve, shtetasi A.H ka fitur mjete financiare në mënyrë të paligjshme të cilat i ka investuar në formën e pasurive të palujtshme.

Gjykata cmon se, ne baze te provave te paraqitura, provohet se gjate periudhes qe i dyshuari A.H ka qene i perfshire ne veprimtarine kriminale ne fushen e trafikimit te narkotikeve sepse provohet se ka konsumuar elementet e vepres penale te “Trafikimit te narkotikeve” si dhe ne periudhen e mevoneshme, ka kryer investime

ne drejtim te pasurive te paluajteshme, vlera e te cilave, haptazi nuk perputhet me veprimtaruine e ligjeshme ekonomike te te verifikuar nga akuza se ka kryer nga shtetasi A.H ne ate periudhe.

Keshtu, provohet ne gjykim se me kontratën nr.xxxx rep. xxxx kol. datë 02.09.2002 shtetasi A.H ka blerë nga shtetasi Q.P një sipërfaqe trual prej 600 m ndodhur ne zonën kadastrale nr.xxxx, në lagjen nr. xx Plazh, Durrës për shumën prej 900 000 lekë. Kjo sipërfaqe toke është blerë pasi shitësi kishte marre mw parw një lejë ndërtimi për banesë tre kate me vendimin nr. 10 datë 02.08.2002 nga Bashkia XXXX. Rezulton se kjo leje eshte zbardhur, pra eshte bere funksionale, vetem në datën 15.01.2003.

Në datën 13.01.2003, midis shtatsit A.H si pronar i truallit dhe shoqërisë së ndërtimit “xxxx”, sh.p.k. është lidhur një kontratë sipërmarrje për ndërtimin e objektit sipas kondicioneve të lejës së ndërtimit.

Me vone, ne vitin 2005, provohet se shtetasi A.H, ka kerkuar e realizuar ndryshimin e objektit dhe te funksionit te tij, per te cilin ka investuar shuma te konsiderueshme parash sepse, mbi kete truall dhe objekt, ka marrë lejen me nr. 05 datë 06.10.2005 te ndërtimit nga Komuna XXX, me objekt shtimin e dy kateve dhe ndryshimin e destinacionit nga goninë banimi, në lokal një kat(katin e pare) dhe hotel katër kate.

Pra ne baze te provave te paraqitura nga akuza, gjykata vlereson se shtetasi A.H është subjekt i ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 **“Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”** sepse jo vtem qe ka prova se ai ka kryer nje nga veprat penale te parashikuara ne nenin 3 te ligjit 10192, por edhe sepse jane gjendur nen posedimi ne pronesine e tij pasuri, te cilat nuk justifikohen dukshem me veprimtarine ekonomike te rregjistrar te tij.

Personi qe kerkohet t’i sekuestrohet pasuria, A.H nuk rezulton të ketë patur në Shqipëri aktivitet tregtar të regjistruar ne periudhen perpara vitit 2006, ndersa ka te dhena te mjaftueshme per te dyshuar se shuma financiare të përdorura për ndertimin e objektit, dhe paisjen e tij sipas funksionit aktual, janë nga veprimtaria e tij kriminale ne fushen e trafikimit te lendeve narkotike.

Ndërtimi i objektit provohet se ka filluar, ne nje date te papercaktuar, por jo me pare se data 15.01.2003 kur eshte dorezuar leja e ndertimit.

Aktualisht rezulton e provuar se ky objek eshte ndertuar dhe se prej vitesh funksionon si hotel dhe Bar-Restorant në përdorim të familjarëve të shtetasit A.H te cilet ne periudhen qe ai ka qene ne paraburgim, rreth pranveres se vitit 2008, kane hyre ne kontakte dhe ne marreveshje me nje shtetasin Kosovar M.M

Ky e fundit e manaxhon kete objekt qe emertohet me emrin e shkurtuar te te pandehurit A pasi quhet Bar-Restorant-Hotel "XXX" dhe eshte i paisur me te gjithë monbilimin e nevojshme dhe aksesore per funksinoimin siopas destinacionit qe ka.

Faktet e mesiperme u provuan ne gjykim me provat shkresore si vijon:

- 1.Vendim për regjistrimin e procedimit pasuror datë 25.06.2010.
- 2.Relacion i prokurorit per hetimin pasuror ndaj shtatsit A.H
- 3.Vendimi nr. 10 datë 26.03.2010 i Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë me të cilin është shpallur fajtor dhe dënuar shtatsi A.H
- 4.Procesverbalet e datës 28.06.2010 për kqyrjen e regjistrit të pasurive të palujtshme të ZRPP Durrës së bashku me fletën e regjistrit dhe kontratën e shitblerjes nr. XXX rep. XXXX Kol.
- 5.Procesverbalet e datës 02.07.2010 për kqyrjen e dokumentave të ndodhura në fashikullin e procedimit penal nr. XXX të vitit 2007 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës së bashku me dokumentacionin e nxjerrjes ë lejave të ndërtimit nga shtatsi A.H gjithsej 26 fletë
- 6.Procesverbalet e datës 18.06.2010 për seksuetrimin e dokumentave lidhur me aktivitetin tregtar të shtetasit M.M si dhe provesverbalet e deklarimeve te dhena nga shtetsit M.H,dhe M.M.

Ne analize e vleresim te ketyre provave, Gjykata bindet se jane rrethanat e parashikuatr nga nenit 11/1/a të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, pasi cmon se ka rrezik që kjo pasuri të humbasë, dëmtohet ose dhe tjetërsohet, prandaj me qëllim ruajtjen e saj, është e nevojshme vendosja e masës së sekustrimit.

Ndonese objekti qe duhet te sekuestrohet nuk eshte i rregjistruara ne Zyren e Rretgjistrimit te Pasurive te Paluajteshme, ai eshte lehtesisht i identifikueshem sepse eshte ngritur mbi truallin e rrgjistruar ne Zyren e Rregjistrimit te paluajteshme Durres , mne zonen kadastrale nr XXX, ne lagjen XX, Plazh Durres si dhe objekti shoqerohet me dokumetacionin e plote nga KKRT-ja Durres per paisjen me leje ndertimi ne vitin 2003 dhe 2005.

Meqenese sipas nenit 12 te ligjit 10912, ky gjykim u zhvillua vetem me prezencen e prokurorit, urdherohet sekretaria gjyqesore te njoftoje zoteruesit e pasurise qe sekuestrohet, shtetasin A.H, sipas neneve 130 e vijues te K.Pr.Civile, ne vendbanimin e tij si dhe ne venduin ku vuan denimin penal.

Per ekzekutimin e ketij vendimi, ne perputhje me nenin 14 te K.Pr.Penale urdherohet zyra e permbarimit gjyqesor ne Durres, ndersa per adminbistrimin e pasurise se sekuestruar ngarkohet eksperti I.C, administrator prane Agjencise per Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara ne Ministrine e Financave.

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenin 212 e vijues te K.Pr.Civiledhe ne nenet; 3/1/d, 3/2/a, 3/4 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”;

V E N D O S I

Pranimin e kerkeses.Sekuestrimin e pasurisë te njohur si objekti Bar-Restorant- Hotel “XXX”, i perbere nga 5+1/2 kate, me sipërfaqe ndërtimi 240 m2 për çdo kat; aktualisht në gjendje pune sipas emertimit te tij. Sekuestrimi i objketit urdherohet te behet se bashku me të gjitha pajisjet dhe aksesoret e e nevojshem per ushtrimin e aktivitet tregatar.

Kjo pasuri qe sekuestrohet gjendet e te ndërtuar mbi truallin me sipërfaqe 600 m2 ne zonën kadastrale nr. XXX, në lagjen nr. xx, Plazh, Durrës.

Për ekzekutimin e ketij vendimi te ngarkohen Zyrat e Permbarimit Gjyqësor e Rrethit Durrës, ndërsa per Administrimin dhe perdorimin e pasurive te paluajtshme të ngarkohet eksperti I.C, Administrator pranë Agjencise per Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara në Ministrinë e Financave Tirane.

Urdherohet sekretaria gjyqesore te dergoje menjehere kopje te ketij vendimi ne institucionet e mesiperme si dhe per njoftimin e zoteruesit te pasurise A.H, ne banesen e tij si dhe ne vendin ku vuan denimin penal.

Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit per Krime te Renda brenda afatit ligjor.

U shpall ne Tirane me **14.07.2010 ora 15.50.**

SEKRETARE

GJYQTARI

Suela Murataj (Arapi)

Gurali BRAHIMLLARI